



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

26768/1 Prot.

Tiranë, më 22.11/2017

**Lënda:** Njoftim për miratimin e “Udhëzues mbi klasifikimin në Nomenklaturën e Kombinuar të mallrave të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë”

**TË GJITHË DEGËVE DOGANORE  
TË GJITHA AGJENCIVE DOGANORE  
TË GJITHË DREJTORIVE NË DPD**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim “Udhëzues mbi klasifikimin në Nomenklaturën e Kombinuar të mallrave të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë”.

Këtë udhëzues, mundet t’a gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda IKONOMI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 26768 Prot.

Tiranë, më 22 / 11 / 2017

U R D H Ë R

Nr. 58, datë 22 . 11 . 2017

Për

**Miratimin e Udhëzuesit “Mbi klasifikimin në Nomenklaturën e Kombinuar të mallrave të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë”<sup>1</sup>”**

Në zbatim të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Bazuar në nenin 737, të Vendimit 651 dt.10.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në mbështetje të pikës 1/b/i të Pjesës VIII/1 të VKM nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi klasifikimin në Nomenklaturën e Kombinuar të mallrave të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë”, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Të merren masat nga strukturat kompetente për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, njohjen dhe zbatimin me korrektesë të këtij Udhëzuesi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Belinda IKONOMI

<sup>1</sup> Ky udhëzues përaftron pjesërisht: Udhëzuesit Informues të EU (2013 C 105 01) “Mbi klasifikimin në Nomenklaturën e Kombinuar të mallrave të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë”.

**UDHËZUES**  
**MBI KLASIFIKIMIN NË NOMENKLATURËN E KOMBINUAR TË**  
**MALLRAVE TË VENDOSURA NË GRUPE/KOMplete PËR SHITJE ME**  
**PAKICË**

Rregulli i Përgjithshëm i Interpretimit (RPI) 3 (b) parashikon dhe klasifikimin e "mallrave të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë".

Për qëllimet e këtij Rregulli, termi "mallra të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë" nënkupton mallrat që:

- a) përbëhen të paktën nga dy artikuj të ndryshëm që janë, *prima facie*, të klasifikueshëm në krerë të ndryshëm;
- b) përbëhen nga produkte ose artikuj të vendosur së bashku për të përmbushur një nevojë të veçantë ose për të kryer një aktivitet specifik; dhe
- c) vendosen në një mënyrë të përshtatshme për shitje të drejtpërdrejtë për përdoruesit pa ri-paketim (p.sh., në kuti ose në valixhe).

*(Shih gjithashtu Sistemin e Harmonizuar (S.H.) për Rregullat e Përgjithshme të Interpretimit 3(b) dhe (6))*

Kushtet e sipërpërmendura duhet të përmbushen të gjitha njëkohësisht.

Rregullat e mësipërme nuk zbatohen për 'grupe/komplete' të cilat duhet të klasifikohen në bazë të RPI 1 si dhe 1 dhe 6 kur termi 'grup' është në vetë përshkrimin e një kodi NK, si për shembull :

- 6308 00 00 — Grupe të përbëra nga pëlhurë e endur dhe fije, ... të vendosur në paketa për shitjen me pakicë ...,
- 8206 00 00 — Veglat e dy apo më shumë krerëve ..., vendosur në një grup për shitjen me pakicë,
- 9503 00 70 — Lodra të tjera, të vendosura në grupe/komplete apo në pajisje të caktuara,

apo për shkak të dispozitave të veçanta si për shembull :

- Shënimi 3 në Seksionin VI,
- Shënimi 1 në Seksionin VII,
- Shënimi 14 në Seksionin XI,
- Shënimet 3 dhe 7 në Kapitullin 61.
- Shënimet 3 dhe 6 për Kapitullin 62.

## PJESA A

### ‘... janë, *prima facie*, të klasifikueshëm në krerë të ndryshëm ...’

- (1) Sipas S.H. në RPI 3 (b) kushti i parë për dy ose më shumë artikuj të ndryshëm që të konsiderohen si "mallra të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë" është se ato duhet të klasifikohen në krerë të ndryshëm.
- (2) Megjithatë, sipas GIR 6 dhe shënimit përkatës të S.H. i cili parashikon se "Rregullat nga 1 deri në 5 përcaktojnë, *mutatis mutandis*, klasifikimin në nivele nënkreu brenda kreut të njëjtë", të dy ose më shumë artikuj të ndryshëm që klasifikohen në të njëjtin kre, por në nënkrerë të ndryshëm, mund të konsiderohet si një grup në kuptim të GIR 3 (b), me kusht që përmbushin kushtet e sipërpërmendura.

#### Shembull:

Mallrat e vendosura së bashku për shitje me pakicë të përbërë nga një shishe shampo (3305 10 00) dhe një shishe bojë për lyerje flokësh (3305 90 00) që përdoren për trajtimin e flokëve konsiderohen si një grup/komplet brenda kreut 3305.

- (3) Megjithatë, dy ose më shumë produkte të ndryshëm që klasifikohen në të njëjtin kre dhe gjithashtu në të njëjtin nënkre nuk mund të konsiderohen si një grup/komplet brenda kuptimit të GIR 3 (b), sepse ato nuk i përmbushin kushtet e sipërpërmendura.

#### Shembull :

Mallrat e vendosura së bashku për shitje me pakicë të përbërë nga një pastrues, toner dhe hidratues. Në këtë rast të gjitha produktet klasifikohen në nëntitullin/nënkreun 3304 99 00, prandaj artikujt nuk përbëjnë një grup/komplet.

## PJESA B (I)

### ‘... të vendosura së bashku për të përmbushur një nevojë të veçantë apo kryer një aktivitet specifik ...’

- (1) Për qëllime të klasifikimit të grupe/kompleteve, artikujt individualë të grupit/kompletit janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin dhe kanë për qëllim të përdoren së bashku ose në lidhje me njëri-tjetrin për të përmbushur një nevojë të veçantë ose për të kryer një aktivitet specifik.
- (2) Termi "nevojë e veçantë" mund të interpretohet gjerësisht, meqë për të përmbushur një nevojë të veçantë, artikujt mund të përdoren ose sipas një rendi të caktuar (për shembull, një grup kozmetik për kujdesin e lëkurës që përbëhet nga disa produkte) ose rastësisht (për shembull, një trapan dhe një set 'upa' (shih gjithashtu pikën B (I) (5) (d)).

- (3) Termi "aktivitet specifik" mund të përshkruhet si një veprim i kryer në një rast të caktuar / të veçantë dhe artikujt e grupit/kompletit përdoren zakonisht gjatë këtij rasti.
- (4) Situatat kur mallrat konsiderohen/nuk konsiderohen si të vendosura së bashku për të përmbushur një nevojë të veçantë ose veprimtari specifike:
- (a) Fakti që artikujt janë vendosur së bashku si një dhuratë (për shembull, për Krishtlindjet, Festën e Nënës, Ditën e Shën Valentinit, etj.) nuk do të thotë automatikisht se ato janë vendosur së bashku për të përmbushur një nevojë specifike apo ose për të kryer një aktivitet specifik. Ngelet të shqyrtohet rast pas rasti. Gjithashtu, artikujt e paraqitur së bashku dhe kanë të njëjtin dizajn/motive dekorative (për shembull, secila prej tyre e zbukuruar me lule trëndafili) nuk duhet të klasifikohen si mallra të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë, përveç rasti kur ato vendosen së bashku për të përmbushur nevoja të veçanta ose për të kryer një aktivitet specifik. Për shembull, një koleksion artikujsh të përbërë nga një orë dore, një kalkulator elektronik xhepi dhe një stilolaps, të gjitha që kanë të njëjtat motive dekorative, të vendosura së bashku për shitje me pakicë në një kuti të vetme, nuk përbëjnë një grup brenda kontekstit GIR 3 (b), sepse këto artikuj nuk janë vendosur së bashku për të përmbushur një nevojë të veçantë ose për të kryer një aktivitet specifik.
- (b) Të përdorur në të njëjtin vend/mjedis nuk supozohet domosdoshmërisht se përmbushin një nevojë të veçantë ose të kryejnë një aktivitet të caktuar. Për shembull, një 'koplet plazhi', që përmban një qese plazhi, një peshqir larës dhe një frisbee, nuk përbën një grup brenda kontekstit të GIR 3 (b). Megjithëse artikujt po përdoren në plazh, ato janë për aktivitete krejtësisht të ndryshme (banjë dhe lojë) dhe nuk janë të lidhura me njëri-tjetrin.
- (c) Fakti që artikujt përdoren nga një person i caktuar ose nga një grup personash (fëmijë, persona që kanë të njëjtin profesion ose pasion, etj.) nuk do të thotë automatikisht se ato konsiderohen mallra të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë. Ngelet të shqyrtohet nëse ato vendosen për të përmbushur një nevojë të veçantë ose për të kryer një aktivitet specifik.
- (ç) Kombinimi i ushqimit dhe pijeve nuk lejohet përveç rasteve kur përdoret për përgatitjen e një pjate të vetme:
- i. llojet e ushqimeve të ndryshme/pijet, përbërësit e të cilave kanë për qëllim të përdoren së bashku në përgatitjen e pjatave, të cilat janë të gatshme për t'u ngrënë menjëherë, ushqimet apo pija do të klasifikohen në bazë të RPI 3(b);
- ii. rregull, megjithatë, nuk mbulon përzgjedhjet e produkteve të vendosura së bashku dhe që përbëhen nga ushqime të ndryshme, pije alkoolike ose pije që nuk kanë për qëllim të përdoren së bashku për të përgatitur një pjatë ose vakt të gatshëm për t'u ngrënë ose një pije. Nëse artikujt nuk ndërveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të përbëjnë një pjatë ose vakt të gatshëm për t'u ngrënë, ose nuk janë një pije, ato nuk konsiderohen të jenë një grup dhe çdo artikull duhet të klasifikohet veçmas në kreun e duhur. Për shembull, të ashtuquajturat 'shportat e Krishtlindjeve', të cilat përbëhen nga mallra të ndryshëm, për shembull: djathë, verë, shampanjë

apo liker, çaj, reçel, vaj ulliri, mjaltë, patë, crëza, fruta, etj. duhet të klasifikohen veç e veç.

Sidoqoftë, kombinimi i ushqimeve dhe pijeve, të destinuara për përgatitjen e një pjate të vetme ose të ushqimit (për shembull, një "përgatitjet për një tiramisù" që përmbajnë një proporcion relativ të verës Marsala që do të përdoret për përgatitjen e tiramisù), duhet të klasifikohen në bazë të GIR 3 (b) si një grup/komplet.

Në anën tjetër, nëse një kombinim është i destinuar si për 'ngrënie dhe për t'u pirë', edhe nëse artikujt janë vendosur së bashku për shitje me pakicë, ato nuk konsiderohen të jenë një grup brenda kuptimit të GIR 3 (b), sepse ato nuk plotësojnë një nevojë të veçantë ose nuk përdoren për të kryer një aktivitet specifik;

iii. Llojet e ndryshme të pijeve/produkteve ushqimore dhe pajisjeve shtëpiake duhet të klasifikohen veçmas, për shembull, një "grup kafeje" i vendosur së bashku për shitje me pakicë me mbështjellës plastik dhe që përfshin :

- pluhur kafe me shije (aromatike),
- shkopinj kanelle,
- një grirëse e vogël metalike prej çelik inoksi,
- një kontenitor metalik me kapak (që përmban pluhur kafeje),
- një gotë qeramike

do të klasifikohet sipas produkteve të ndryshme në krrerët 2101 (pluhur aromatik me aromë të çastit), 0906 (shkopinj kanelle), 8205 (grirëse e vogël metalike), 7323 (enë metalike me kapak), 6912 (gotë qeramike) .

Këto produkte nuk mund të konsiderohen si "mallra të vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë" brenda kuptimit të GIR 3 (b), sepse artikujt nuk plotësojnë një nevojë të veçantë ose nuk shërbejnë për të kryer një aktivitet specifik.

Megjithatë, një filxhan plastik njëpërdorimësh/jo i ripërdorshëm e një vlerë të papërfillshme (shih gjithashtu pjesën B(III) 'grupe/komplete që përfshijnë një artikull të vogël / të papërfillshëm') me një qese që përmban kafe dhe një qese që përmban sheqer të vendosur së bashku për përgatitjen e një filxhani kafe do të klasifikohen si një grup/komplet.

(5) Shembuj të produkteve apo artikujve të cilat mund të klasifikohen si një set me referencë për GIR 3(b):

(a) Set banjo/mirëqenie të përbërë nga produkte të ndryshme si xhel dushi, shampo me fluska, sapun, larës trupi ose një kombinim shampo, krem fytyre dhe krem për duart, etj. Gjithashtu, artikujt që do të përdoren me to si p.sh. sfungjer ose peshqir i vogël - artikujt duhet të përdoren njëkohësisht, sipas një radhe të caktuar ose rastësisht dhe janë plotësues. (Megjithatë, shih gjithashtu pjesë B) (I) (6) (a) assortimente të përbëre nga artikuj për higjienën dhe të tjera - klasifikim i veçantë.

(Shih gjithashtu pjesë B) III) asortimente të përbërë nga artikuj me vlerë të vogël/-te papërfillshëm', shembull (ii).)

Nëse artikujt e mësipërm vendosen së bashku për shitje me pakicë në një qese plastike me zinxhir, qesja plastike do të klasifikohet në bazë të GIR 5 (b) pasi është e një lloji të përdorur normalisht për paketimin e mallrave të tilla.

- (b) Kit mbijetese që përmban vetëm sende me vlerë të vogël, për shembull: dy kunjat sigurie çeliku, dy grepa çeliku, një linjë peshkimi prej tekstili (31 m), një busull e vogël, një gjilpërë çeliku, dy shkopinjtë për ndezje zjarri, një tel bakri (91 cm), një litar shumë përdorimesh (3 m), katër kunjat shkrepse kundra ujit, një kuti shkrepse, një bilbil plastik, një shirit vetëngritës (30 cm), një teh brisku, dy pambuqe të ngopura me alkool (për desifektim plagësh), dy ankerplast vetëngjitës, një qese plastike e ri-mbyllshme, dy gozhdë çeliku, një copë alumini me efekt pasqyrë me pjesën e mbrapme ngjitëse, një laps, një pako supë të thatë, një copë çamçakëz. Të gjithë përbërësit e asortimenteve janë të vendosur në një kuti metalike alumini me përmasa 11 cm (gjatësi) x 7,7 cm (gjerësi) dhe 2,3 cm (thellësi) dhe shiten në një paketim blister. Përbërësit janë të dizajnuara për njëpërdorim në raste emergjence, për shembull, një ndalim i papritur në një zonë të izoluar dhe janë destinuar për një nevojë specifike: mbijetesa;
- (c) Paketat e pacientit për të shtruar në spital/paketat e higjienës gjatë udhëtimit, duke përfshirë disa artikuj me vlerë të ulët, për shembull, letra për të pastruar, një stilolaps, një furçë dhëmbësh, pastë dhëmbësh, shampo, letra të lagura për fytyrën dhe trupin, sterilizues për duart, deodorant, balsam për buzët, sapun, limë thonjsh dhe një letër e lagur higjienike: ose

artikujt higjienik të përbërë, për shembull, nga një sapun i mbështjellë me qese plastike, një peshqir letre i parfumosur, disa shami prej letre dhe dy letra për vendin e tualetit (jo të ripërdorshme) të paraqitura së bashku me një zarf plastik i cili është i palosshëm.

Megjithatë, grupet/kompletet e ngjashme për udhëtim me linja ajrore që përfshijnë përveç artikujve të tualetit dhe pantofla, pizhame, etj. - nuk duhet të klasifikohen si grupe/komplete në bazë të GIR 3(b), pasi pantoflat, pizhamet, etj. nuk janë produkte për kujdesin personal.

- (ç) Komplet trapani dhe 'fiksuesit e gozhdëve në mure', p.sh, pjesët e trapanit prej çeliku me shpejtësi të lartë rrotullimi, pjesët e trapanit rrotullues prej druri, pjesët e trapanit prej metali të rëndë, pjesët e kaçavidave me një mbajtëse magnetike dhe 'fiksuesit e gozhdëve në mure'. Të gjithë përbërësit janë të vendosur në një kuti plastike me një ndarje plastike - edhe nëse artikujt zakonisht nuk përdoren së bashku për të kryer një aktivitet specifik dhe vetëm disa prej tyre mund të përdoren në një rast të caktuar, ato mund të konsiderohen se vendosen së bashku për të përmbushur një nevojë të veçantë, për shembull, rinovimin, rregullimin ose përmirësimin e shtëpisë.
- (d) Set i rinovimit ose të bërit-vetë që përbëhet, për shembull, nga sendet për heqjen e letres së murit dhe për piktura, të tilla si furça boje, lapsa zdrukthëtarësh, rule boje, thika speciale, gërvishtës, spatul piktorësh, metër shirit, testues të tensionit, bojë e mirë, etj. Mallrat i shërbejnë një nevojë të përbashkët për 'rinovimin e murit'.

(e) Set i përbërë nga një libër dhe një CD që lidhet me librin e futur në kopertinën e saj (për shembull, CD përmban ushtrime gjuhësore të lidhura me librin) do të klasifikohet në bazë të GIR 3 (b) pasi së bashku shërbejnë për të përmbushur një nevojë të veçantë (për shembull, studimi i një gjuhë të huaj).

(6) Shembuj të produkteve apo artikujve të cilat nuk mund të klasifikohen si grup/komplet duke iu referuar GIR 3(b):

(a) Grupe/kompletet e banjës, grupe/kompletet e higjienës të përbërë nga sende të larjes (si xhel dushi, sapun) dhe sende shtesë që do të përdoren veçmas si pantofla, pasqyra dore, furçat e flokëve, qirinj dekorativ, etj. Artikujt e ndryshëm nuk përdoren së bashku ose në lidhje me njëri-tjetrin. Megjithëse ato mund të përdoren në të njëjtin vend (banjë), ato janë të dizajnuara për nevoja të ndryshme. Artikujt e larjes përdoren për 'larje / trajtim të trupit', ndërsa artikujt e tjerë përdoren, për shembull, për 't'u veshur, për trajtimin e flokëve'. (Shih gjithashtu pikën B (I) (5) (a), shembullin e një grupi/kompleti për banjo të klasifikuar si një grup dhe pjesa B (III) që përfshin një artikull të vogël / të papërfillshëm, shembull (ii).

(b) Kutia me sende të shumëllojshme që përbëhet, për shembull nga gozhdë të ndryshëm prej çeliku, grepa pjesërisht të veshura, vida me gozhdë çeliku, grepa të ndryshme prej çeliku të veshura me gome (përfshirë grepat për të varur foto), mbështetëse të rafteve plastike me kunjat e çelikut, unaza prej gome, kunjat e çelikut dhe plastikës, unazat e çelikut, kapëse letre prej çeliku, prizat të papërpunuara të ndryshme, vida prej çeliku, rrota prej gome ose letre. Përbërësit e grupit/kompletit janë vendosur në pesë enë plastike të ndara, të cilat mund të futen në një kornizë plastike portative. Në krahasim me, për shembull, grupin e rinovimit të përmendur në pikën B (I) (5) (c), kutia me sende të shumëllojshme nuk plotëson një nevojë të veçantë, por në vend të kësaj ka një mori aplikacionesh më të gjera se rinovimi, fiksimi ose përmirësimi në shtëpi. Ajo përmban artikuj të tillë si llastike, mbajtëse çelsash dhe kapëse letrash ... që shërbejnë për qëllime të tjera.

## PJESA B) II)

### '... grupe/komplete të paplota ...'

1. Nëse një ose më shumë artikuj të një "grupi/kompleti" nuk plotësojnë të njëjtën nevojë të veçantë ose nuk janë të dizajnuara për të kryer të njëjtën veprimtari specifike si artikujt e tjerë të një "grupi/kompleti" të paketuar së bashku për shitje me pakicë, secili prej tyre duhet të klasifikohet veç e veç. Nuk është e mundur të ndërtohet një grup i marrë nga një 'grup/komplet i paplotë' dhe të veçohen vetëm disa nga artikujt [shih gjithashtu S.H. në GIR 3 b), X)].
2. Artikujt mund të klasifikohen si një grup/komplet vetëm nëse të gjitha prej tyre janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe përdoren së bashku. Në të gjitha rastet e tjera, vetëm nëse disa nga artikujt lidhen me njëri-tjetrin dhe përdoren së bashku, secili artikull duhet të klasifikohet veç e veç.
3. Për shembull, në rastin e grupit/kompletit të banjës [shih pikën B I) 6) a)] që përbëhet nga xhel dushi, sapun, locion trupi dhe pantofla, çdo artikull duhet të klasifikohet veçmas, pasi pantoflat nuk plotësojnë të njëjtën nevojë të veçantë.



## PJESA B) III)

### ‘... grupe/komplete që përfshijnë një artikull me vlerë të vogël/të papërfillshme ...’

- (1) Mallrat e vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë mund të kombinohen me një artikull me vlerë të vogël/të papërfillshme (në raste të caktuara dhe me më shumë se një artikull) të një vlere të papërfillshme që nuk ka lidhje me artikujt e tjerë të kompletit (i cili nuk ka të njëjtën nevojë të veçantë ose veprimtari specifiqe) dhe që normalisht do të klasifikohet më vete.
- (2) Prania e një artikulli me vlerë të vogël/të papërfillshme mund të mos merret në konsideratë në përcaktimin nëse një grup i artikujve përbën një komplet (*'rregulli de minimis'*) dhe të gjithë artikujt duhet të klasifikohen së bashku, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme :
  - (a) Artikulli është thjesht një element ndihmës/i pa rëndësishëm në të gjithë kompletin, p.sh. quhet si artikull surprizë;
  - (b) nuk ndryshon karakteristikat e kompletit ;
  - (c) vlera e artikullit është e papërfillshme në krahasim me vlerën totale të mallrave të vendosura në grup për shitje me pakicë;si dhe
  - (d) Artikulli vetë zakonisht ka përdorim praktik të vogël ose të parëndësishëm, ose ka përdorim të kufizuar, për shembull, nuk mund të përdoret vazhdimisht ose përdorimi i tij është i kufizuar.

#### Shembuj:

- (i) “Grup/komplet kreativiteti” i përbërë nga artikuj të ndryshëm për një aktivitet krijues (një shall me thurje të vogël trekëndëshi prej xhinsi, një thurje me shirit, diamant artificial dhe ngjitës për të dekoruar shall) dhe një artikull i vogël surprizë – gomë që fshin, pa lidhje me aktivitetin, për shitje me pakicë në një kuti kartoni. Këto mallra do të klasifikoheshin si një grup, goma që fshin do të klasifikohet së bashku me artikujt e tjerë të grupit/kompletit;
- (ii) ‘ Grup/komplet banjo’ - që përmban preparate të ndryshme tualeti (për shembull, xhel dushi, sapun, kripë vaske dhe locion trupi) dhe një qiri të një vlere të papërfillshme, të vendosur për shitje me pakicë në një kuti letre. Qiriu do të klasifikohet së bashku me artikujt e tjerë të grupit. Megjithatë, artikujt e një "grupi/kompleti për banjo" të ngjashme që përmbajnë një qiri dekorativ që nuk është me vlerë të papërfillshme do të klasifikohet veçmas, pasi qiri rrit vlerën e kompletit, kohëzjatja e përdorimit të tij mund ta kalojë atë të artikujve të tualetit dhe ka një vlerë më të madhe [shih pikën B) 1) 6) a)].
- (iii) Komplet vizatimi që përmban një vizore, një kompast vizatimi, një laps dhe një mprehës lapsi, të paraqitur së bashku me ngjitës prej letre të vegjël – këto të fundit duhet të klasifikohen së bashku me grupin pasi ato janë një element i parëndësishëm, njëpërdorimësh dhe ka një vlerë të papërfillshme, etj.;

(iv) Komplet i artikujve tekstil që përbëhet nga një shall i kreut 6117 dhe dorashka të kreut 6116 të paraqitura së bashku me vathët e metaleve bazë të kreut 7117. Të gjitha artikujt duhet të klasifikohen veçmas, pasi vathët janë më shumë se një element me një vlerë të papërfillshme: Ata kanë një përdorim praktik dhe vlera e tyre nuk është e papërfillshme.

(3) Rregulli i mësipërm mund të zbatohet rast pas rasti dhe zbatohet edhe kur një 'artikull kryesor' paraqitet së bashku me një artikull të vogël/të papërfillshëm.

Për shembull, një kuti cerealesh që mban një artikull surprizë të një vlerë të papërfillshme si p.sh. një lodër apo ngjitës plastike të vegjël nuk do të klasifikohet veçmas. Gjithsesi nëse kutia e cerealeve përmban një CD me muzikë, lojra PC apo softë are, artikujt do të klasifikohen në mënyrë të ndarë, pasi CD është më shumë se një element me një vlerë të papërfillshme dhe ka një funksion të rëndësishëm të veçantë.

### PJESA C

#### '... vendosen në një mënyrë të përshtatshme për shitje direkt te përdoruesi pa ripaketim...'

(1) Kjo pjesë parashikon se për t'u konsideruar si një 'grup/komplet', është i nevojshëm plotësimi i të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) të gjithë artikujt e 'kompletit' paraqiten në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën deklaratë;

(b) të gjithë artikujt paraqiten në të njëjtën paketim, si p.sh. në një kuti mbajtëse, çantë plastike, kuti, rrjetë, ose (nëse janë apo jo të paketuara) të lidhura së bashku me shirit, etj.;

(c) të gjithë artikujt vendosen bashkë në një mënyrë të përshtatshme për shitje të menjëhershme tek përdoruesit pa ripaketim.

(2) Sidoqoftë, si përjashtim nga pika 1) b), mallrat e vendosura në grupe/komplete për shitje me pakicë mund të paraqiten në pako të ndara kur justifikohen, për shembull, për shkak të përbërjes së artikujve si madhësia, pesha, forma, përbërja kimike, për arsye të transportit ose për arsye sigurie, me kusht që ato të jenë të përshtatshme për shitje drejtpërsëdrejti për përdoruesit pa ripaketim.

Kjo situatë mund të pranohet vetëm në rastet kur:

(a) mallrat paraqiten në 'proporcione relative', për shembull, një tavolinë ngrënie me dimensione të përshtatshme për katër persona dhe katër karrige për ngrënie; Në krahasim me 'proporcione jo-relative' siç janë tri tavolina ngrënie (dimensione të përshtatshme për katër persona), dhe një karrige për ngrënie.

si dhe:

(b) mallrat janë vendosur në një formë të tillë që tregon qartësisht se ato janë bashkë, për shembull :

(i) paketat duhet t'i referohen njëri-tjetrit (me numra, figura, emërtim komercial, etj.; ose

(ii) dokumentet përmendin se mallrat në fjalë janë në pako të ndara, por i përkasin njëra tjetrës.